



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 94

Prishtinë, më 25.11.2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S1

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Mufera Shinik, Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Ardian Gjini, Haki Demolli, Armend Zemaj dhe Sreten Ivanoviq.

Munguan: Albulena Haxhiu dhe Gëzim Kelmendi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Artan Canhasi – EULEX; Blerta Aliu – Koha Ditore; Blerta Gashi – Rrokum TV; Arton Demhasaj – Çohu; Syle Ahmeti – Kosova Sot; Ardian Bajraktari – MD; Lumnije Murati – ZPRK; Petrit Hysaj dhe Lejla Selimi – OSBE.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.10.2013;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-220 për investimet e huaja;
4. Formimi i grupit punues për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
5. Formimi i grupit punues për Projektligjin për aktet normative;
6. Formimi i grupit punues për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.10.2013

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes, të mbajtur më 7.10. 2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-220 për investimet e huaja

Kryetari, e paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente në Projektligjin për investimet e huaja dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje për projektligjin dhe amendamentet e propozuara.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 04/L-220, për investimet e huaja dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Formimi i grupit punues për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik në përbërje:

- Albulena Haxhiu - kryesues;
- Behar Selimi – anëtar, dhe
- Haki Demolli - anëtar.

5. Formimi i grupit punues për Projektligjin për aktet normative

I. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për aktet normative në përbërje:

- Arsim Bajrami- kryesues;
- Arben Gashi - anëtar;
- Albulena Haxhiu - anëtar;
- Ardian Gjini - anëtar, dhe
- Sreten Ivanović - anëtar.

6. Formimi i grupit punues për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë

Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, në këtë përbërje:

- Armend Zemaj - kryesues;
- Albulena Haxhiu - anëtar;
- Mufera Shinik - anëtar, dhe
- Halit Krasniqi - anëtar.

7. Të ndryshme

a. Caktimi ekspertëve për ofrimin e mbështetjes profesionale të grupeve punuese

- I. Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që listës së ekspertëve t'i bashkëngjitet edhe Idriz Tahiri.
- II. Komisioni vendosi që ekspertë për ofrimin e mbështetjes profesionale të grupit punues për Projektligjin për aktet normative, caktohen: Idriz Tahiri, Ilaz Ramajli dhe Lazim Salihu.
- III. Ekspertë për ofrimin e mbështetjes profesionale të grupit punues për Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht, caktohen: Besim Kelmendi dhe Salih Mekaj.
- IV. Ekspert për ofrimin e mbështetjes profesionale të grupit punues për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, caktohet Idriz Tahiri.

Mbledhja përfundoi në orën 12:35.

E përgatiti
Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit
Arben Gashi
